



Teksti zyrtar siç është amendamentuar me 11.11.2010

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve,

Në bazë të nenit 64.2 pika (a) dhe (b), nenit 128.2, si dhe nenit 20 dhe neni 29.2 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nxjerr:

RREGULLËN ZGJEDHORE NR. 06/2008
QENDRA E NUMËRIMIT DHE E REZULTATEVE

Neni 1
Përkufizimet

1.1 Qendra e Numërimit dhe e Rezultateve (QNR) është lokacioni ku numërohen fletëvotimet me kusht, fletëvotimet për votim jashtë Kosovës dhe çdo fletëvotim i rregullt me kërkesë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) ose të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), ndërkaq Formulari i Përputhjes së të Dhënave dhe i Rezultateve (FPR-të) nga secili VV kontrollohen dhe tabelohen dhe më pas Formulari i Rezultatit të Kandidatëve (FRK) dhe Formulari i Rezultateve të Dengut (FRD) tabelohen dhe kështu përpilohen rezultatet përfundimtare.

1.2 Me zarfin e fletëvotimit me kusht (ZFK) nënkuptohet zarfi i jashtëm në të cilin janë të shënuara të dhënat personale të votuesit që voton me fletëvotim me kusht. Brenda Zarfit të FK-së duhet të jetë Zarfi i Fshehtësisë, i cili përmban fletëvotimin(et) të hedhura.

1.3 Me fletëvotimin për votim përmes postës nënkuptohet fletëvotimi me të cilin votohet sipas dispozitave të parashtruara në nenin 96 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, gjegjësisht rregullën zgjedhore (03/2008) për Votim Jashtë Kosovës.

1.4 Formulari i përputhjes së të dhënave dhe i rezultateve (FPR) është formulari i bashkëngjitur si shtojcë në këtë rregull zgjedhore dhe i miratuar nga KQZ para zgjedhjeve për qëllim të përputhjes së votave-rezultateve në një vendvotim.

1.5 Formulari i rezultatit të kandidatëve (FRK) është formulari i bashkëngjitur si shtojcë në këtë rregull zgjedhore dhe që është i miratuar nga KQZ para zgjedhjeve, për qëllim të regjistrimit së rezultateve të kandidatëve.

1.6 Formulari i Rezultateve të Dengut (FRD) është formulari i bashkëngjitur si shtojcë në këtë rregull zgjedhore dhe që është i miratuar nga KQZ-ja para zgjedhjeve, me qëllim të regjistrimit të rezultateve nga Votimi me Kusht, Votimi me Nevoja të Veçanta dhe Rrethana të Jashtëzakonshme dhe Votimi Jashtë Kosovës.

1.7 Me Listën Përfundimtare të Votuesve (LPV) nënkuptohet lista e votuesve siç përcaktohet në nenin 3 dhe nenin 8.6 të Ligjit mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe në nenin 2.2 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës.

1.8 Lista përfundimtare e votuesve e një vendvotimi (LPV VV) është lista e votuesve të caktuar për votim në një VV të rregullt, që mban nënshkrimet e atyre votuesve të cilët kanë hedhur votat e rregullta në atë VV, siç theksohet në nenin 3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe nenin 2.2. të Ligjit për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës.

1.9 Lista e votuesve me kusht (LVK) e një VV-je është lista e votuesve të cilët votojnë me Fletëvotim me Kusht (FK) në një VV të dyfishtë, siç theksohet në nenin 3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe nenin 2.2 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës ose gjatë programit të votimit të personave me nevoja të veçanta dhe rrethana të veçanta, sipas nenit 99 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe nenit 25 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës dhe rregullës së zgjedhjeve Nr. 04/2008.

1.10 PZAP do të thotë Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia, një organ i pavarur, përgjegjës për vendosjen për parashtrësit dhe ankesat në lidhje me procesin zgjedhor.

Neni 2

Dispozitat e Përgjithshme

2.1 Koordinator i QNR-së është personi përgjegjës për menaxhimin e të gjithë personelit dhe aktiviteteve që zhvillohen në QNR në konsultim me Kryeshefin Ekzekutiv të Sekretariatit të KQZ-së dhe gjithashtu edhe për implementimin e saktë të kësaj Rregulle të zgjedhjeve. Koordinator i QNR-së rekomandon dhe zbaton procedura teknike të përcaktuara me këtë Rregull Zgjedhore.

2.2 Pas rekomandimit nga koordinatori i QNR-së, Kryeshefi Ekzekutiv i SKQZ-së e emëron një nga anëtarët e personelit të QNR-së që të veprojë si Zëvendës Koordinator i QNR-së në rast të mungesës së koordinatorit të QNR-së.

Neni 3

Mbikëqyrja dhe Vëzhgimi

Sipas nenit 3 dhe nenit 104 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe nenit 26 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës:

3.1 Të gjitha aktivitetet që zhvillohen në QNR mund të mbikëqyren nga anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ-së). Anëtarët e KQZ-së mund të vëzhgojnë aktivitetet që zhvillohen në QNR në çfarëdo kohe.

3.2 Brenda QNR-së jo më tepër se katër (4) vëzhgues të akredituar nga e njëjta Organizatë e Akredituar mund të jenë të pranishëm njëkohësisht për të vëzhguar zgjedhjet.

3.3 Përfaqësuesit e mediave të akredituara nga KQZ, gjithashtu mund ta vëzhgojnë aktivitetin e zhvilluar në QNR. Përfaqësuesit e mediave të akredituara nga KQZ, duhet të lejohen brenda QNR-së për një kohë të shkurtër, me kusht që prania e tyre të mos e pengojë procesin e numërimit dhe se nga i njëjti medium nuk duhet të ketë më shumë se katër (4) persona.

3.4 Pa marrë parasysh dispozitat e kësaj rregulle, nëse Kryeshefi Ekzekutiv i SKQZ-së sipas gjykimit të tij/saj të lirë dhe me kërkesë të koordinatorit të QNR-së konstaton se numri i vëzhguesve të akredituar të zgjedhjeve ose i përfaqësuesve të mediave të akredituara të pranishëm

brenda në QNR është duke e penguar procesin, ai/ajo duhet t'i udhëzojë vëzhguesit dhe/ose përfaqësuesit e mediave që të zvogëlojnë numrin e tyre.

Neni 4

Pranimi dhe kontrollimi fillestar i materialit

4.1 Pas marrjes së materialit nga secila KKZ, personeli i QNR-së duhet të pranojë Formularin e Përputhjes së Rezultateve (FPR), Formularin e Rezultateve të Kandidatëve (FRK), Listën Përfundimtare të Votuesve (LPV), Listën e Votuesve me Kusht (LVK), Librat e Votimit dhe thasët e mbyllur të Zarfave të Fletëvotimeve me Kusht (ZFK) dhe kutitë e mbyllura të votimit. Numrat e shiritave mbyllës të kutive të votimit dhe thasët e ZFK-ve duhet të verifikohen. Personeli i QNR-së duhet të shënojë secilin artikull të marrë ose që mungon në raportin e pranimit të QNR-së, një kopje e të cilit i është bashkangjitur kësaj rregulle si Shtojcë.

4.2 Personeli i QNR-së duhet të bëjë auditime dhe hetime përkitazi me materialet e marra sipas nenit 4.1, nëse;

- (a) nuk mund të përcaktohet numri i vendvotimit, i materialeve të marra; dhe/ose
- (b) një FPR, FRK dhe/ose LPV-ja mungojnë; dhe/ose
- (c) ka ndonjë parregullsi ose shmangie të tjera nga procedurat ligjore.

4.3 Sekretariati i KQZ-së duhet t'ia dorëzojë koordinatorit të QNR-së zarfet e fletëvotimeve për votim përmes postës siç është e paraparë me rregulloren 03 / 2008 për Votim Jashtë Kosovës.

Neni 5

Auditimi i formularëve të rezultateve dhe hetimet

5.1 Personeli i QNR-së duhet të kontrollojë saktësinë e të dhënave të shënuara në çdo FPR dhe duhet t'i mbajë materialet për auditim dhe/ose hetim, në rast të mospërputhjes mbi nivelin e tolerancës paraqitur në mes të:

- (a) numrit të përgjithshëm të fletëvotimeve të rregullta të gjetura në kutinë e votimit krahasohet nga numri i përgjithshëm i nënshkrimeve në LPV
- (b) numrit të ZFK-ve të gjetura në Kutinë e ZFK-ve krahasohet me numrin e emrave në LVK për.
- (c) numri total i votave vlefshme, votat e zbrazëta dhe votat jo valide duke krahasuar me numrin e votave të rregullta të gjetura në Kutinë e Votimit;
- (d) numri total i votave të pa përdorura, të votave të dëmtuara, të votave të rregullta të gjetura në kutinë e votimit, ZVK të gjetura në qesen e ZVK të krahasuara me numrin e fletëvotimeve të pranuar.

Niveli i tolerancës do të jetë i paraqitur me vendimin e KQZ-së, me rekomandimin nga Koordinatori i QNR- së.

5.2. Në rast se hetimi që është bërë në bazë të nenit 4.2 dhe nenit 5.1 të kësaj rregulle, nuk e zgjidh problemin e identifikuar, Koordinatori i QNR-së duhet t'i paraqesë rekomandim me shkrim KQZ-së, që ajo të vendosë.

5.3 Gjithë materiali i mbajtur për hetim nga personeli i QNR-së, ose deri sa KQZ-ja të vendosë siç përcaktohet në nenin 5.2, duhet të deponohet në një vend të sigurtë me qasje të kufizuar deri në pritje të hetimit.

Neni 6

Verifikimi i zarfeve të fletëvotimeve me kusht dhe i zarfeve të fletëvotimeve për votim përmes postës

6.1 Vetëm Zarfet e Fshtësisë të Votave me Kusht të cilat referohen, lidhen me Zarfin e Votave me Kusht dhe Zarfet e Votimit Përmes Postës të cilat mund të referohen, lidhen me dokumentet e identifikimit të votuesit, do të procedohen për verifikim.

6.2 Personeli i QNR-së duhet të konfirmojë Zarfin e Fletëvotimit me Kusht (ZFK) ose Zarfin e Fletëvotimit për Votim Përmes Postës, nëse:

- (a) emri i votuesit në ZFK ose në Zarfin e Fletëvotimit për Votim Përmes Postës gjendet në LPV;
- (b) votuesi i njëjtë nuk ka votuar me një fletëvotim tjetër të rregullt, Fletëvotim me Kusht (FK) tjetër ose me ndonjë Fletëvotim tjetër për Votim Përmes Postës.
- (c) Zarfi i Fletëvotimit për Votim Përmes Postës përmban një kopje të dokumentit të identifikimit që kërkohet sipas nenit 3.3, pika a dhe b të Rregullës së Zgjedhjeve nr. 03/2008 “Votimi Jashtë Kosovës”; dhe
- (d) votuesi nuk ishte përjashtuar nga Lista e Votuesve me vendim të PZAP-it apo me vendim të Gjykatës Komunale.

6.3 QNR-ja duhet t’i mbajë dhe duhet t’i ndajë të gjitha ZVK të konfirmuara nga ZVK e pa konfirmuara për cilindo lloj të zgjedhjeve. QNR-ja do të numëroje vetëm fletëvotimet nga zarfet e konfirmuara dhe të pranuar.

E njëjta do të aplikohet për zarfet e votimit përmes postës dhe fletëvotimet përmes postës.

6.4 Personeli i QNR-së i hap ZFK-të e konfirmuara që referohen në nenin 6.3 dhe:

- (a) Refuzon Zarfin e VK nëse gjendet i zbrazët ;
- (b) Refuzon Zarfin e VK nëse përmban më shumë se një Zarf të Fshtësisë;

6.5 Personeli i QNR-së do t’i hap Zarfat e Fshtësisë të Konfirmuara të Votimit me Kusht dhe Zarfat e Fshtësisë të Konfirmuara të Votave të Votimit Përmes Postës që rrjedhë nga neni 6.3 dhe do t’i korrigjojë fletëvotimet për zgjedhjet e konfirmuara, dhe:

- (a) Refuzon Zarfin e Fshtësisë nëse nuk përmban fletëvotim.
- (b) Refuzon Zarfin e Fshtësisë nëse përmban me shumë se një fletëvotim për të njëjtën zgjedhje.
- (c) Pranon Zarfin e Fshtësisë nëse përmban fletëvotimin(et) për zgjedhjen(et) përkatëse dhe nëse votuesi është regjistruar në komunën për të cilën ai ose ajo ka hedh votën.

Neni 7

Numërimi i fletëvotimeve në QNR

7.1 Fletëvotimet e gjetura brenda zarfeve të pranuar të fshtësisë, e të cilat nuk janë refuzuar ashtu siç përcaktohet në nenin 6, si dhe çfarëdo fletëvotimi tjetër që kërkohet të numërohet me vendim të KQZ-së ose të PZAP-it, duhet të numërohen në QNR.

7.2 Fletëvotimi duhet të konsiderohet i pavlefshëm, nëse:

- (a) në fletëvotim është shënuar më shumë se një subjekt politik; ose
- (b) mënyra se si është shënuar fletëvotimi e bën qëllimin e votuesit të paqartë; ose
- (c) nuk është vulosur me vulën zyrtare të fletëvotimeve, përveç nëse është fletëvotim për votim përmes postës, i cili nuk kërkohet të vuloset; ose
- (d) është fletëvotim për votim përmes postës që nuk është fletëvotim i pranueshëm siç përcaktohet në nenin 1.3 të Rregullës së Zgjedhjeve nr. 03 / 2008 të, Votimi Jashtë Kosovës.

7.3 Fletëvotimi që nuk është i shënuar duhet të konsiderohet si fletëvotim i zbrazët.

7.4 Rezultatet e procesit të numërimit duhet të shënohen në Formularin e Rezultateve të Dengut (FRD), një kopje e të cilit është bashkangjitur si shtojcë e kësaj Rregulle, në një FPR ose FRK, kur është e përshtatshme.

Neni 8

Ankesat përkitazi me procesin në QNR

8.1 Ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QNR, konform nenit 105 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe nenit 26 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës dorëzohen me shkrim në PZAP brenda 24 orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar.

8.2 Paraqitja e ankesës nuk pengon ose ndërpret procesin e numërimit.

8.3 Në bazë të dispozitës së nenit 105.3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe nenit 26 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, për të gjitha ankesat në PZAP, do të vendoset jo më vonë se 72 orë pas marrjes së tyre në zyrat qendrore të PZAP-it.

Neni 9

Rezultatet e zgjedhjeve

9.1 Pasi që të gjitha ankesat e mbetura përkitazi me votimin dhe numërimin të jenë shqyrtuar dhe vendosur nga PZAP-i dhe pasi të jetë marrë ndonjë masë e kërkuar nga KQZ-ja, personeli i QNR-së duhet të nxjerrë totalin e rezultateve të të gjitha FPR-ve, FRK-ve dhe FRD-ve të pranuar dhe të përpilojë rezultatet e zgjedhjeve.

9.2 Me rezultatet e zgjedhjeve nënkuptohet numri i votave të fituara nga secili subjekt politik i certifikuar për çdo zgjedhje për të cilat kanë konkurruar, si dhe numri i votave të fituara nga secili kandidat dhe gjithashtu edhe të gjitha të dhënat tjera të kërkuara në bazë të nenin 106.4 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

9.3 Në raste të jashtëzakonshme para certifikimit të rezultateve, KQZ-ja mund të urdhërojë rinumërimin e votave në cilindo Vendvotim, Qendër të Numërimit ose edhe përsëritjen e votimit në një Qendër Votimi apo në një Komunë.

9.4 Rezultatet e zgjedhjeve janë përfundimtare dhe të detyrueshme, sapo të certifikohen nga KQZ-ja, në pajtim me nenin 106.1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe nenit 26 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës.

9.5 Në bazë të rezultateve të certifikuara, KQZ-ja duhet ta përgatisë listën e të gjitha mandateve për zgjedhjet e certifikuara dhe ia paraqet Presidentit të Kosovës rekomandimin për plotësimin e këtyre mandateve.

Neni 10
Hyrja në fuqi

Kjo Rregull e ndryshuar zëvendëson Rregullën e mëparshme për Qendrën e Numërimit dhe të Rezultateve dhe hyn në fuqi më 25.06.2009.

Nesrin Lushta

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve
